




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Përmbyllo Me Datë 27-03-2025			
Nr. Fajllor Org. Broj	Nr. Broj	Shkencë e Proje	Vlera Vlerësim
01-	110/05-	260	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për Dhënie e Pronës së Palujtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.03.2025 miraton këtë:

V E N D I M

për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurimit të hapur për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë deri 20 vite (njëzetë vite) për njësi kadastrale me Nr.P-70101003-01607-2, në zonën kadastrale në Binçë, me sipërfaqe prej 32552 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Komisioni përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

1. Xhelal Veseli - anëtar i komisionit - përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
2. Alban Sokoli - anëtar i komisionit - përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
3. Taulant Haxhiu, përfaqësues i kuvendit të komunës.
4. Nexhat Halili, përfaqësues i kuvendit të komunës.
5. Albulena Selmani, përfaqësues i sektorit joqeveritar.

Neni 2

Detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Nr.06/L-092, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019) dhe Rregullorës Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës. Komisioni vlerësohet udhëheq me procedurat mbi dhënie e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit.

Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarve të komisionit kurdoherë që kërkohet.

Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me Komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e konkurimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit në Komunën e Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi